



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2231 Prot

Peshkopi, më 20.06 .2024

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.39


**Datë:** 20.06.2024

**“Për planin e përmisimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Dibër”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.512/1 prot.

Peshkopi, më 25.06.2024

**Lënda:** Për vendimin nr.39, datë 20.06.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

**BASHKISË DIBËR**

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.39, datë 20.06.2024 “*Për planin e përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Dibër*”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 39 Datë 20/06/2024

**“Për planin e përmisimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Dibër”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 23, pika 12, neni 54 pika “k”, ligji nr.69/2018 “Për sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe relacionit të pregatitur nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor dhe Sektori i Arsimit Kulturës, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **20.06.2024** me 16 vota pro, 0 kundër dhe 1 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Planit të Përmisimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Dibër”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **20.06.2024**.

Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA

